

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Fredi Beleri trazon Greqinë, pas komenteve për njeriun e “Agimit të Artë”
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajoni/fredi-beleri-trazon-greqine-pas-komenteve-per-njeriun-e-agimit-te-arte-i587145
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 17:56:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 17:55:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	40e3b48df911d9bf0e6bf14568062d2b2cd3657d1993fbad41952a438260916c
TEKSTI	980bb0ce27615b725d06d30dc36e1d944ba4dd1e12ad538f9679a943dd381336
PAMJA	ff81642b43e06dbf82e5ae72ef0d2909be8af49e24b69729661e3910f52a3e42

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0de175b863ae7f1de67b58eb7c2eb03c6dd6fad742453c13d4d422d6afb10494
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e6de1b535956bbc0d3f1977997734a5d8ef6212b247caf423164a2e3e3b2297a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0de175b863ae7f1de67b58eb7c2eb03c6dd6fad742453c13d4d422d6afb10494>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



IE [Fredy Beleri trazon Greqinë, pas komenteve për njeriun e "Agimit të Artë"](#)Kazërma e GJKKO-se se Shkalles se Pare duhet bojkotuar komplet!Pas Hages, kush do ta çojë pe fundit

Fredy Beleri trazon Greqinë, pas komenteve për njeriun e “Agimit të Artë”



19 Shtator 2026, 19:55Rajoni TEMA



Fredy Beleri bëri një deklaratë për Ilias Kasidiarisin, duke shkaktuar reagime në Greqi, dhe më pas u zbyth duke tërhequr pikërisht fjalinë që kishte ndezur debatin.

Eurodeputeti i Demokracisë së Re foli për Kasidiarisin në një intervistë të dhënë më 10 shtator në televizionin ONE. Kur u pyet për ish-deputetin e Agimit të Artë, Beleri tha se nuk e njihte dhe se nuk kishte bashkëpunuar me të, por më pas bëri deklaratën që e futi në përplasje politike.

“E di se është një nga të paktët grekë që e kreu burgun deri në ditën e fundit”, tha Beleri për Kasidiarisin.

PASOK-u e interpretoi atë si lartësim të Kasidiarisit dhe kërkoi që zëdhënësi i qeverisë të distancohej publikisht nga eurodeputeti i Demokracisë së Re. Në deklaratën e tij, PASOK-u e cilësoi Kasidiarisin si të dënuar dhe mbështetës të nazizmit dhe e vendosi deklaratën e Belerit në kontekstin e debatit për rikthimin e tij në politikë.

Beleri fillimisht kishte shkuar edhe më tej. Pasi foli për vuajtjen e dënimit, ai tha se Kushtetuta dhe demokracia duhet të zbatohen për të gjithë, përfshirë Kasidiarisin, dhe shtoi: “Nuk kam frikë prej tij”. Por kur deklarata mori përmasa politike, Beleri ndryshoi kurs.

Më 19 shtator, ai doli me një postim publik dhe tërhoqi pikërisht fjalinë që kishte shkaktuar reagimet. “Një shprehje e imja në një pjesë të intervistës në One ishte e pavend dhe e tërheq”, deklaroi Beleri.

Pra, nuk kemi vetëm një debat mbi interpretimin e fjalëve të tij. Vetë Beleri pranoi se formulimi ishte i pavend dhe e tërhoqi.

Por eurodeputeti tentoi njëkohësisht të zhvendoste një pjesë të përgjegjësisë te PASOK-u. Ai akuzoi partinë opozitare se kishte shkëputur fjalinë nga pjesa tjetër e intervistës dhe se kishte krijuar një imazh që, sipas tij, nuk përputhet me qëndrimet që ka mbajtur ndër vite.

Beleri deklaroi gjithashtu se nuk ka “asnjë lidhje me zotin Kasidiaris dhe atë që ai përfaqëson”. Ai e paraqiti qëndrimin e tij si respekt ndaj demokracisë, institucioneve dhe shtetit të së drejtës.

Për të mbrojtur pozicionin e tij, Beleri solli më pas edhe Demokracinë e Re. Ai tha se ndihet krenar që i përket forcës politike gjatë qeverisjes së cilës u mbledhën dosjet për Agimin e Artë, ato iu dorëzuan drejtësisë dhe ndryshoi kuadri ligjor për organizatat kriminale.

Por ky argument nuk ndryshon kronologjinë e episodit.

Më 10 shtator, Beleri veçoi publikisht si element pozitiv faktin se Kasidiaris kishte qëndruar në burg “deri në ditën e fundit”. PASOK-u reagoi dhe kërkoi distancimin e qeverisë. Më 19 shtator, Beleri e quajti deklaratën e vet “të pavend” dhe e tërhoqi.

PASOK-u e zgjeroi ndërkohë çështjen edhe te Demokracia e Re. Duke iu referuar informacioneve mediatike, partia kërkoi shpjegime për një takim të drejtorit të zyrës së kryeministrit në Parlament, Michalis Bekiris, me Giannis Kourgianidis, të cilin PASOK-u e identifikoi si drejtues të Frontit Kombëtar dhe bashkëbisedues të Kasidiarisit. Partia kërkoi të dinte edhe nëse Kyriakos Mitsotakis kishte dijeni për takimin.

Kështu, Beleri hyri në debat duke folur për Kasidiarisin si një njeri që e kishte kryer dënimin deri në fund, ndërsa doli prej tij duke deklaruar se fjalja e vet ishte e pavend.

Tërheqja nuk e fshin deklaratën fillestare. Ajo vetëm dokumenton se, pas reagimit politik që shkaktoi, vetë Beleri vendosi të mos e mbronte më formulimin që kishte përdorur.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Pas Hagës, kush do ta çojë përpara drejtësinë për krimet e luftës në Ballkan?

19:35 Rajoni

Serbia shfaq robotë të armatosur disa ditë pas hapjes së fabrikës kineze

18:55 Rajoni

[Hamza viziton familjet Thaçi, Veseli dhe Krasniqi: Nuk janë vetëm dhe nuk do të jenë kurrë](#)

17:45 Rajoni / 1 koment



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.